

Pozicioni i punës: Psikolog/e

Data e publikimit

15 Mars 2023

Kohëzgjatja

12 muaj, me kohë të plotë

Pagesa

Pagesa në monedhën vendase

Raporton tek

Oficeri i Programit për Mbrojtjen e Fëmijëve

Vendi

Bulqizë

Afati për aplikim: 26 Mars 2023

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Terre des hommes Misioni në Shqipëri (Tdh) është një organizatë jofitimprurëse që ka funksionuar për më shumë se 30 vjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke udhëhequr krijimin dhe forcimin e një sistemi kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Fusha e ekspertizës së Terre des hommes përfshin nga ndërhyrjet e drejtpërdrejta psiko-sociale me fëmijët ne nevojë dhe familjarët e tyre, si dhe dhe anëtarët e komunitetit, fuqizimin e institucioneve shtetërore lokale dhe kombëtare, si dhe aktorët kyç përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe mbështetjes profesionale për të ngritur dhe forcuar strukturat përgjegjëse për fëmijët, politikat, standardet dhe procedurat. Gjithashtu, Terre des hommes ka dhënë kontributin e saj për të integruar çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve në politikat dhe strategjitë sociale të qeverisë qendrore, përmes lobimit dhe advokimit.



PËRSHKRIMI I ROLIT

Terre des hommes Misioni në Shqipëri po kërkon të rekrutojë një Psikolog/e në kuadër të projektit **“Ndërtimi i reziliencës parandaluese dhe shërbime të reagimit të menjëhershëm për fëmijët viktime të trafikimit dhe formave të rënda të dhunës”** të drejtuar nga UNICEF Shqipëri dhe financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Ai/ajo do të jetë përgjegjës për zbatimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe proceseve të projektit, si dhe të ofrojë shërbimeve të integruara për mbështetjen e familjeve, fëmijëve dhe të rinjve në rrezik trafikimi në Bashkinë Bulqizë dhe Njësitë Administrative Fushë Bulqizë, Zerqan, Shupenzë and Gjoricë.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Identifikon në mënyrë proaktive dhe të vazhdueshme rastet në nevojë për shërbime psikologjike nga zonat e synuara të projektit, si dhe bashkëpunon me stafin e qendrës komunitare, institucionet dhe aktorët e tjerë për të pasur referime të rasteve.
- Merr pjesë dhe kontribuon në tryeza të rrumbullakëta multidisiplinare për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve dhe/ose rasteve të prekura nga rreziku i trafikimit ose mungesa e mbrojtjes.
- Kryen vlerësime psikologjike për adoleshentët, të rinjtë dhe prindërit që identifikohen dhe/ose referohen për mbështetje psikologjike.
- Zhvillon plane, objektiva dhe ndërhyrje të trajtimit individual ose në grup, që adresojnë nevojat e identifikuar.
- Ofron këshillim psikologjik dhe/ose terapi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet në rrezik trafikimi.
- Mobilizon drejtuesit e grupeve rinore nga komunitetet vulnerabël, mbështet funksionimin dhe planifikimin e grupeve rinore dhe zbatimin e iniciativave rinore përmes Metodologjisë Ti Krijon.
- Zhvillon aktivitete psikosociale dhe aktivitete për zhvillimin e aftësive për jetën me të adoleshentët dhe të rinjtë, duke vendosur objektiva psikosociale për pjesëmarrësit gjatë realizimit të tyre.
- Lehtëson klasat e prindërimit me tema që lidhen me mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimin, praktikën e mira të edukimit dhe disiplinimit, mbrojtjen dhe aftësitë për jetën.
- Lehtëson sesione informuese, sensibilizuese dhe aktivitete ndërgjegjësuese për fëmijët, të rinjtë, familjet dhe komunitetet lidhur me tema specifike psikologjike në bashkinë Bulqizë dhe Njësitë administrative.
- Dokumenton dhe ruan në mënyrë konfidenciale dosjen për secilin rast apo grup në trajtim, në bazë të etikës së profesionit.
- Konsulton dhe harton politikën e mbrojtjes së fëmijëve që përfshin veprime për parandalimin dhe mbrojtjen nga abuzimi në QKMF në bashkëpunim me fëmijët, të rinjtë dhe familjet përfituese dhe siguron zbatimin e saj.

KRITERET PËR APLIKIM

- Diplomë bachelor në psikologji ose një specializim në psikologji.
- I licensuar nga Urdhëri i Psikologut të Shqipërisë.
- Minimumi 3 vjet përvojë pune të ngjashme me grupe në nevojë, veçanërisht në lidhje me shërbimin psikologjik.
- Përvoja e mëparshme pune me projekte për fuqizimin e të rinjve.
- Përvoja të mëparshme pune me OJF dhe projekte të shoqërisë civile.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi.
- Të jetë proaktiv, energjik dhe me aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur.
- Për këtë pozicion kërkohet njohja e mirë e gjuhës angleze.



PËR TË APLIKUAR:

Të gjithë aplikantët që përmbushin kriteret e kërkuara, të dërgojnë CV-në e tyre dhe Letrën e Motivimit në adresën e emailit alb.hr@tdh.ch

Ju lutem, në subjekt të emailit të vendosni “Aplikim për Psikolog/e”.

Politika e mbrojtjes së fëmijëve:

Të angazhohet për të respektuar Politikën e Menaxhimit të Rrezikut të Terre des hommes, duke përfshirë Politikën e mbrojtjes së fëmijëve, Politikën e sigurisë, Politikën kundër mashtrimit/korrupsionit dhe Politikën e referimit.

Për shkak të numrit të madh të aplikimeve, Tdh nuk është në gjendje t'u përgjigjet të gjithëve individualisht. Ju lutem, keni parasysh që vetëm kandidatët nga lista e ngushtë do të kontaktohen.

Pajtueshmëria me RrPMDh (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave)

Duke dërguar aplikimin tuaj, ju pranoni që të dhënat tuaja personale të përdoren në procesin e rekrutimit. Të gjitha dokumentet që do të kërkojmë në hapa të ndryshëm të procesit të rekrutimit do të përdoren vetëm për këtë qëllim.

I gjithë stafi i përfshirë në rekrutim dhe përzgjedhje është i vetëdijshëm se zbatohen rregullat për mbrojtjen e të dhënave dhe se informacioni personal do të trajtohet në mënyrë konfidenciale

